



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 08 dhjetor 2020  
Nr. ref.:RK 1660/20

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI202/19**

Parashtrues

**Demir Krasniqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. nr. 263/2019, të 26 shtatorit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës  
Themelore në Prishtinë, C. 1265/2013, të 30 korrikut 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS**

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Demir Krasniqi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 263/2019, të 26 shtatorit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 1265/2013, të 30 korrikut 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 263/2019, të 26 shtatorit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 1265/2013, të 30 korrikut 2014, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e pronës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 11 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: f
7. Më 12 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi dokumentacionin shtesë në Gjykatë.
8. Më 4 dhjetor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI202/19. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dorëzua Gjykatës Supreme.
9. Më 11 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 28 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës (blerësi) lidhi kontratë mbi shitblerjen me D. Zh., M. Zh., G. Zh. dhe M. Zh., (shitësit), ku objekt i kontratës ishte ngastra kadastrale nr. 251-1, me kulturë arë, në vendin e quajtur "Selishte", me sipërfaqe prej 0.57,9 hektarë, Zona Kadastrale Preocë.

Parashtruesi i kërkesës pohon se më 28 maj 2011, në xhirollogarinë e shitësve, nga ai është paguar shuma prej 14.000,00 euro, përmes Raiffeisen bankës.

11. Më 24 maj 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër D. Zh., për vërtetimin e kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit të paluajtshmërisë nr. 251-1 në emër të tij, në librat kadastral. Përmbajtja e padisë thotë: *“Edhe pse paditësi në tërësi e ka paguar çmimin e shitblerjes të kësaj patundshmërie i padituri edhe përkundër pretendimeve të paditësit akoma nuk i ka mundësuar vërtetimin e kontratës mbi shitblerjen, me qëllim të regjistrimit të kësaj patundshmërie, në emër të paditësit i cili që nga dita e nënshkrimit është pronar faktik, çka do të thotë se i padituri nuk i ka mundësuar paditësit bartjen në emër të tij, dhe regjistrimin në operatin kadastral”*.

### ***Procedura lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë***

12. Më 28 maj 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore në Prishtinë propozim për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, së 24 majit 2013, kundër D. Zh., për shkak të rrezikut të tjetërsimit apo ndryshmit të gjendjes ekzistuese të paluajtshmërisë së lartcekur.
13. Më 30 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit C. nr. 1265/2013, refuzoi, si të pabazuar, propozimin e parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, për arsye: *“... se në rastin konkret, propozuesi ka nënshkruar kontratën e shitblerjes me kundërshtarin e sigurimit, dhe ka paguar çmimin e shitjes për ngastrën kontestuese, kundërshtari i sigurimit dhe familjaret e tij si: G., M. dhe M. propozuesit ja kanë dhënë autorizimet të vërtetuara në Gjykatën Themelore në Jagodinë, R. e Serbisë, si vr. 2294/2012, dt. 16 mars 2012 dhe vr. 3429/2012, dt. 12 prill 2012, sipas të cilave autorizime, propozuesi është autorizuar nga autorizimdhënësit të disponoj me ngastrën kontestuese, kështu që në rastin konkret propozuesi nuk e ka bërë të besueshme rrezikun e sigurimit të kërkesëpadisë, që është njëra prej kushteve komulative për të caktuar masën e sigurimit në kuptim të dispozitës së nenit 297 të LPK-së, kjo sepse propozuesi është pajisur me autorizim. Veç kësaj në rastin konkret propozimi është drejtuar vetëm ndaj D-së, kështu që të njëjtit, i mungon legjitimiteti i plotë pasiv dhe për këtë arsye u refuzua propozimi për caktimin e masës së sigurimit”*. Këshilla e gjykatës parasheh që pala e pakënaqur brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, mund të ushtrojë ankesë në shkallë të dytë.

### ***Procedura lidhur me shpronësimin (eksproprijimin) dhe kompensimin e dëmit***

14. Më 7 shkurt 2014, me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: MMPH), kompania Imobilia-shpk, kishte bërë vlerësimin e çmimit të shpronësimit të paluajtshmërisë kontestuese, duke caktuar çmimin prej 15 euro për metër katror, të sipërfaqes prej 4905 m<sup>2</sup>, ku vlera totale e pagesës ishte 73,575.00 euro. Qëllimi i shpronësimit nga MMPH-ja ishte realizimi i projektit rrugor, Segmenti 7.3 i autostradës Morinë - Merdare, lidhja me rrugën magjistrale M2 dhe autostradën Prishtinë - Shkup

R6. Sipas shkresës, pronarë nga 1/4 pjesë e paluajtshmërisë nr. 251-1, figurojnë D.Zh., M.Zh., G.Zh. dhe M. Zh.

15. Më 29 maj 2015, parashtruesi i kërkesës, pasi kishte kuptuar për procesin e shpronësimit të paluajtshmërisë kontestuese, ushtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shpronësim dhe kompensim të dëmit në vlerë prej 73.575,00 euro, të shkaktuar nga akti i MMPH-së për shpronësim të paluajtshmërisë së sipërcekur.
16. Më 13 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit C. nr. 2099/15, e konsideroi të tërhequr padinë e parashtruesit të kërkesës, për shkak se në seancën kryesore nuk u paraqitën as parashtruesi i kërkesës dhe as mbrojtësi i tij, dhe se të njëjtit nuk kishin arsyetuar mosparaqitjen e tyre në seancën e shqyrtimit kryesor.
17. Në Aktvendimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 2099/15, të 13 prillit 2018, thuhet: *“Gjykata ka caktuar seancën kryesore për datë 13.04.2018, në të cilën paditësi dhe i autorizuari i tij janë ftuar në mënyrë të rregullt, dhe kjo rrethanë vërtetohet përmes procesverbalit të seancës së datës 19.03.2018, por kanë munguar, mungesën nuk e kanë arsyetuar, ndërsa e autorizuarja e të paditurit, ka propozuar që gjykata të vepron sipas ligjit. Meqenëse paditësi dhe i autorizuari i tij nuk kanë marrë pjesë në seancën kryesore dhe nuk e ka arsyetuar mungesën, gjykata në kuptim të nenit 423.3 të LPK-së e konsideron të tërhequr padinë”*.
18. Më 13 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktvendimin e shkallës së parë dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.
19. Më 5 shkurt 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac. 3443/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesi të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 13 prillit 2018, duke arsyetuar: *“Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe si i tillë është nxjerrë me zbatim të drejtë të nenit 423.3 të LPK-se, ku thuhet, se “Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*.
20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3443/2028, të 5 shkurtit 2019, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të të drejtës materiale me propozim që aktvendimet e kundërshtuara të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.
21. Më 26 shtator 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit Rev. nr. 263/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe vërtetoi të dy aktvendimet e instancave me të ulëta gjyqësore,

duke arsyetuar se pretendimet për mospjesëmarrje të vetë parashtruesit të kërkesës dhe të mbrojtësit të tij në shqyrtimin kryesor të kërkesëpadisë për shpronësim dhe kompensim të dëmit ishin të pabazuara sepse për të njëjtat nuk ekziston ndonjë dëshmi e faktuar.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës, sa i përket refuzimit të propozimit të tij për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, pretendon: *“... sikur të ishte APROVUAR kërkesa për masën e sigurisë nuk kishte pas mundësi të tërhiqeshin mjetet me autorizim të falsifikuar, konsideroj se me ligjin e shpronësimit, e drejta ime si person FAKTIK më është shkelur, pasi që unë si i interesuar nuk kam qenë fare i njoftuar përkitazi me shpronësim”.*
23. Ndërsa në lidhje me ushtrimin e kërkesëpadisë për shpronësimin dhe kompensimin e dëmit, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij pronësore, sepse: *“Me vendimin për Shpronësim, më është shpronësuar sipërfaqja e pronës nr. 251-1 të cilën e kam blerë nga D. Zh nga fsh. Dobrevë e Epërme, KK Fushë-Kosovë, Organi Shpronësues nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5794 m<sup>2</sup>, ka shpronësuar sipërfaqen prej 4905 m<sup>2</sup>, ndërsa janë mbetur sipërfaqja prej 889 m<sup>2</sup>, çmimi për m<sup>2</sup> ka qenë 15 € e në total prej 73,575 €. Kjo pronë ka qenë ende në emër të D. Zh M.Zh, M.Zh dhe G.Zh, edhe pse paditësi Demir Krasniqi këtë pronë e ka blerë para se të shpronësohet me datën 28.9.2011 me vullnetin e lirë është nënshkruar kontrata mbi shitblerjen me D. Zh.”.*
24. Tutje, parashtruesi i kërkesës pohon se: *“Paditësi ka pasur autorizim nga shitësi për tërheqjen e mjeteve nga shpronësimi ... Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, shumën e mjeteve prej 73.575 € me autorizim të falsifikuar, mjetet i ka tërhequr M. B., edhe pse MMPH ka pasur njohuri se për këtë pronë kam autorizim origjinal, MMPH nuk e ka pasur parasysh dhe me plotësimin e aplikacionit për tërheqje me autorizim të falsifikuar,... Unë si palë e dëmtuar edhe pse kam kërkuar që të më bëhet pagesa deri më tani nuk kam has në mirëkuptim”.*
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, si rezultat, gjykatat e rregullta: *“... padinë për kompensimin e dëmit e kanë refuzuar pa asnjë bazë ligjore, me të cilën janë shkelur liritë dhe të drejtat e mija të garantuara me Kushtetutë. E drejta në pronë - kompensim është e garantuar edhe me konventën ndërkombëtare e cila garanton pronën e pronarit, si të shejtë”.*
26. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që të aprovojë kërkesën e tij dhe të detyrojë: *të Paditurën MMPH, që në emër të shpronësimit për ngastrën nr. 251-1, sipas fletës poseduese nr. 218, zona kadastrale Preocë, sipërfaqja e shpronësuar prej 4905 m<sup>2</sup> x 15 €, në shumën e përgjithshme prej 73.575.€, me kamatë ligjore 8% nga data e plotfuqishmërisë të vendimit përfundimtar, të detyrohet e paditura MMPH të bëjë pagesën definitive paditësit Demir Krasniqi nga Prishtina”.*



## Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

29. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

30. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 263/2019, të 26 shtatorit 2019, pasi i ka shterur mjetet

juridike në kuptimin formal. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

31. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me paragrafët (1) (b) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

1) *Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:*

*[...]*

*(b) janë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose aktvendimit të kontestuar;*

*[...]*

2) *“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimet e kontestuara i shkelen të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

33. Fillimisht, Gjykata rikujton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të sipërcekura, ndërlidhen me dy sete të procedurave, me 1) propozimin për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, ushtruar me 24 maj 2013 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe ushtrimin e kërkesëpadisë tjetër në lidhje me shpronësimin dhe kompensimin e dëmit, ushtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, më 29 maj 2015.

34. Në këtë kontekst, Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë: **i.** të Aktvendimit [C. nr. 1265/2013] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 30 korrikut 2014, dhe **ii.** Aktvendimit [Rev. nr. 263/2019] të Gjykatës Supreme, të 26 shtatorit 2019 lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke u bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

**(i) Sa i përket pretendimeve lidhur me Aktvendimin C. nr. 1265/2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë**

35. Përkitazi me këto pretendime *procedurën për caktimin e masës së sigurisë*, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet për shkeljen e të drejtës së pronës, duke arsyetuar se sikur të ishte aprovuar propozimi i tij për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë do të evitohej mundësia e tjetërsimit apo e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të paluajtshmërisë kontestuese nga shitësi, si nënshkrues i kontratës së shitblerjes.

36. Gjykata fillimisht rikujton se çdo pretendim i ngritur në kërkesë nga parashtruesit e kërkesave, kërkon dhënien e një përgjigjeje konkrete nga ana e Gjykatës, me kushtin që parashtruesi/it të kenë përmbushur kriteret procedurale të pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Njëri ndër këto kriterë është ai i shterimit të mjeteve efektive juridike. Gjykata rikujton se kriteret e vlerësimit, nëse ky detyrim është përmbushur, janë mirë të përcaktuara në praktikën e Gjykatës dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNj), në harmoni me të cilën Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës më 24 maj 2013 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë dhe një propozim i tillë i është refuzuar nga Gjykata Themelore me Aktvendimin C. nr. 1265/2013, të 30 korrikut 2013.
38. Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës sipas këshillës së gjykatës ka pasur të drejtë të ushtronte ankesë në Gjykatën e Apelit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit. Megjithatë, ai nuk dëshmon dhe provon se një gjë të tillë e ka bërë.
39. Andaj, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund ta vlerësojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtës në pronë, sepse i njëjti e ka humbur mundësinë e ushtrimit të ankesës dhe të vlerësimit të pretendimit të tij në procedurë të rregullt (shih, ngjashëm, Gjykata Kushtetuese, rasti KI41/19 parashtrues: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 15 janarit 2020, paragrafët 64-66, dhe rastet e cituara aty).
40. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë. Pra, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shterojë mjetet juridike në dispozicion, pranë organeve administrative apo gjykatave të rregullta (shih Aktvendimin në rastin KI139/12, *Besnik Asllani*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012, i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; Aktvendimin në rastin nr. KIO7/09, *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18; Aktvendimi në rastin nr. KI89/15, *Fatmir Koci*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 473/2014, i 21 nëntorit 2014, paragrafi 35).
41. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet efektive juridike që i kishte në dispozicion, për sa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës pronësore, në lidhje me refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë.



**(ii) Sa i përket pretendimeve lidhur me Aktvendimin [Rev. nr. 263/2019] të Gjykatës Supreme, të 26 shtatorit 2019, për shpronësimin dhe kompensimit të dëmit**

42. Sa i përket procedurës së shpronësimit dhe kompensimit të dëmit, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të të drejtave të tij pronësore, dhe e ndërlidhë atë me faktin se gjykatat e rregullta e konsideruan kërkesëpadinë e tij, ushtruar më 29 maj 2015, të tërhequr, për shkak të mosparaqitjes së tij dhe të mbrojtësit të tij në seancën e shqyrtimit kryesor.
43. Gjykata së pari rikujton përmbajtjen e nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, të cilat në lidhje me të drejtat pronësore përcaktojnë:

**Neni 46  
[Mbrojtja e Pronës]**

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.*  
[...]

**KEDNJ  
Protokollit nr. 1 Neni 1 [Mbrojtja e Pronës]**

1. *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

**Parimet e përgjithshme**

44. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari thekson se paragrafi 1 i nenit 46 të Kushtetutës e garanton të drejtën e pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik dhe paragrafi 3 i nenit 46 të Kushtetutës garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet në të cilat prona mund të shpronësohet (shih, *mutatis mutandis*, rasti KI50/16, parashtrues i kërkesës Veli Berisha dhe të tjerët, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 marsit 2017, paragrafi 31).
45. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, Gjykata rithekson se neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së përbëhet nga tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura: rregulli i parë

shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshton atë kushteve të caktuara; dhe, rregulli i tretë, ua njeh të drejtën shteteve që të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i çmojnë si të nevojshme për arritjen e një qëllimi (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Sporrong dhe Lonnrot kundër Suedisë*, Aktgjykimi i 23 shtatorit 1982, ankesa nr. 7151/75; 7152/75, paragrafi 61; *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ankesat nr. 25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, 18 shtator 2012; *Sargsyan kundër Azerbaixhan*, ankesa nr. 40167/06, 16 qershor 2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, ankesa nr. 53080/13, i 13 dhjetorit 2016).

46. Gjykata rikujton se të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptimin e të qenurit të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).
47. Sa i përket rregullit të parë, GJEDNJ vazhdimisht ka konstatuar se koncepti i “pasurisë” i cili bën pjesë në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është një koncept autonom, që përfshin si “pasuritë ekzistuese” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri legjitime”. “Pasuritë” sipas këtij koncepti përfshijnë të drejtat “*in rem*” dhe “*in personam*”, siç është pasuria e paluajtshme, e luajtshme dhe interesat e tjera pronësore.
48. Koncepti autonom i “pasurisë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i pavarur nga klasifikimi thjesht formal në ligjin vendor dhe nuk është i kufizuar në pronësinë e të mirave fizike: disa të drejta dhe interesa të tjera që përbëjnë “asete” mund të konsiderohen gjithashtu si “të drejta pronësore”, dhe kështu si “pasuri” për qëllimet e kësaj dispozite. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast veç e veç është nëse rrethanat e rastit, të marra si një tërësi, i janë dhënë parashtruesit të kërkesës si një e drejtë me interes thelbësor të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së (shih, *Depalle kundër Francës* [GC], paragrafi 62; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [DHM], paragrafi 63; *Öneryıldız kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 124; *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], paragrafi 129; *Beyeler kundër Italisë* [DHM], paragrafi 100; *Iatridis kundër Greqisë* [DHM], paragrafi 54; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano kundër Italisë* [DHM], paragrafi 171; *Fabris kundër Francës* [DHM], paragrafi 49 dhe 51; *Parrillo kundër Italisë* [DHM], paragrafi 211; *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 76).

#### a) Pritshmëritë legjitime

49. Koncepti i “pasurisë” dhe i “pritjeve legjitime” kanë një vend qendror në interpretimin e të drejtave pronësore të garantuara me KEDNJ dhe të zhvilluara më tej me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Nga ana tjetër, “pritjet legjitime mund të rezultojnë në pasuri”. Edhe pse neni 1 i Protokollit nr. 1 i

KEDNJ-së zbatohet vetëm për pasurinë ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës, në rrethana të caktuara, një “pritje legjitime” për fitimin e një prone mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, para. 73 dhe 75, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 34443/96 paragrafi 129).

50. Në mënyrë që një “pritshmëri” të jetë “legjitime”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa thjesht një shpresë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt juridik siç është një vendim gjyqësor, që paraqet një interes të pronës në fjalë (shih, *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], paragrafit 49-50; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [DHM], paragrafi 173; *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 103; *Ceni kundër Italisë*, paragrafi 39; dhe *Béláné Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 75). Në të kundërtën, asnjë “pritje legjitime” nuk mund të thuhet se lind, kur ka një mosmarrëveshje sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të ligjit vendor dhe kur kërkesat e parashtruesve më pas refuzohen nga gjykatat kombëtare (shih, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], paragrafi 65; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano v. Italy* [DHM], paragrafi 173; *Béláné Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 75; *Karachalios kundër Greqisë* (vendim), paragrafi 46; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], paragrafi 149).

### **Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret**

51. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme të të drejtës në pronë dhe pasi analizoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje shkëlqen e kësaj të drejte, vlerëson se parimet e lartcekura nuk janë të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës për arsyet vijuese.
52. Fillimisht, para se të vijë në një konkludim, Gjykata i referohet pjesëve relevante të aktvendimit të kontestuar, dhe vëren se Gjykata Supreme, pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i ishte përgjigjur, si më poshtë:

“Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi pretendimet e revizionit të paditësit se për shkak të sëmundjes paditësi nuk ka mundur të prezantojë në seancë pasi ka qenë në shërim në SHBA, por pretendimet e tilla kjo gjykatë i trajton si të pabazuara për arsye se i njëjti ka pasur përfaqësuesin e vet Shefki Syla, avokat nga Prishtina, i cili po ashtu ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt por nuk i është përgjigjur ftesës së gjykatës. Njëherit kjo gjykatë nuk ka mundur të pranojë si të bazuar as pretendimin në revizion, se ditën e caktuar edhe i autorizuari i paditësit ka qenë në emergjencë dhe nuk ka mundur të prezantojë në seancë, për arsye se pretendimet e tilla nuk janë të argumentuara me asnjë provë sipas shkresave të lëndës. Nga ana tjetër, pala paditëse ka mundur në kuptim të nenit 130.2 të LPK-së të parashtrojë propozimin për kthimin në gjendje të mëparshme, në afat të caktuar e çka nuk ka bërë, dhe një propozim i tillë nuk gjendet në shkresat e lëndës, prandaj pretendimet e tilla të palës paditëse, kjo Gjykatë i konsideron si të pabazuara”.

53. Nga si u tha më sipër, Gjykata vëren se përgjigja e Gjykatës Supreme, ka të bëjë me arsyet e shpalljes së kërkesëpadisë së ushtruar më 29 maj 2015 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si të tërhequr nga parashtuesi i kërkesës. Në këtë këndvështrim Gjykata vëren se objekt i kontestit nga parashtuesi i kërkesës pranë gjykatave të rregullta, respektivisht pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ishte “tërheqja e kërkesëpadisë” dhe jo më themeli i kërkesëpadisë ku për objekt shqyrtimi ishte çështja e shpronësimit të paluajtshmërisë kontestuese nga MMPH-ja (e paditura) dhe kompensimi i dëmit nga kjo e fundit.
54. Nga si më sipër, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore të fituar me një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe as me pritje legjitime, sepse parashtuesi i kërkesës nuk ka një të drejtë të pohueshme, me të cilën dëshmon dhe provon se është vërtetuar e drejta e tij pronësore mbi paluajtshmërinë kontestuese në fjalë (shih, ngjashëm, *GJEDNJ rasti Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], parimin e paraqitur në paragrafin 52). Në këto rrethana, parashtuesi i kërkesës nuk mund të pretendojë shkelje të të drejtave të tij pronësore, përderisa gjykatat e rregullta, në rastin e tij shqyrtuan vetëm aspektet procedurale të kërkesëpadisë dhe jo meritat e çështjes, ku do të mund të vendosej në lidhje me 1) procesin e shpronësimit të paluajtshmërisë kontestuese, dhe 2) kompensimin e dëmit nga MMPH-ja.
55. Gjykata tutje thekson se parashtuesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, andaj pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e *GJEDNJ-së Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
56. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtuesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës në pronë është qartazi i pabazuar nga arsyet e lartcekura.
57. Si përmbledhje, sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nga ana e autoriteteve publike, Gjykata konstaton se kërkesa:
- i. në lidhje me procedurën për caktimin e masës se sigurimit të kërkesëpadisë, shpallet e papranueshme, për shkak të mosshterjes së mjeteve efektive juridike, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës;
  - ii. në lidhje me procedurën e ushtrimit të kërkesëpadisë për shpronësim dhe kompensim dëmi, po ashtu shpallet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, sepse parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtës në pronë.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (1) (b), 39 (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 nëntor 2020 njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ajta Rama-Hajrizi